

SVJETLLANA TITINI

HUAZIMET NGA ANGLISHTJA NË TERMINOLOGJINË E SË DREJTËS NË GJUHËN SHQIPE

Ndryshimet në jetën ekonomike, politike e shoqërore të vendit tonë pas viteve '90 u pasqyruan gjerësisht edhe në gjuhë, në mënyrë të veçantë në leksik.

Ajo që bie në sy, në këtë periudhë, janë përmasat shqetësuese që mori dukuria e huazimit për shkak të hyrjes së pakontrolluar të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe. Fjalët e huaja depërtuan, në masë jo të njëjtë, thuhet në të gjitha fushat e jetës. Një ndër këto fusha është edhe e drejta.

Shtresa e huazimeve të leksikut terminologjik të së drejtës ka tërhequr vëmendjen e është bërë objekt studimi në artikuj të ndryshëm nga gjuhëtarët e në ndonjë rast edhe nga specialistë të fushës¹ për dy arsye:

Së pari, sepse e drejta si tërësi e ligjeve, që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet individëve, shtetit e shoqërisë, ka një rol me rëndësi të veçantë në jetën e një vendi. *Së dyti*, një pjesë e leksikut terminologjik të së drejtës, për shkak të ndikimit e shtrirjes që ka kjo fushë në raportet shoqërore, i ka kaluar kufijtë e përdorimit nga një rreth i ngushtë specialistësh, duke u bërë pjesë e leksikut të përgjithshëm të përdorur masivisht nga individët e kanalet e komunikimit me publikun si media e shkruar e ajo vizive, interneti etj.

Pas viteve '90, duke vëzhguar materialin e vjelë nga botime të llojeve të ndryshme si: revista, fletore zyrtare, kode të së drejtës e tekste mësimore që përdoren në sistemin universitar, por edhe nga gjuha e përdorur në median vizive vihet re një shtim i termave nga anglishtja ndër huazimet që kanë hyrë, gjatë kësaj kohe, në terminologjinë e së drejtës.

Ky fakt është bërë pikënisje që objekt shqyrtimi, në këtë punim, të jenë termat e së drejtës të huazuar nga anglishtja të cilët do të analizohen sipas degëve të së drejtës ku kanë hyrë për të hedhur dritë se në ç'masë janë të nevojshme këto huazime në gjuhën tonë, sa i janë përshtatur nga ana strukturore gjuhës shqipe termat që kanë hyrë nga anglishtja apo cilat janë arsyet e mbizotërimit të këtij grupi huazimesh në ditët tona.

Hapja e vendit ndaj botës perëndimore dhe shtimi i universiteteve publike e jopublike në vend që ofrojnë programe të shumta studimi në fushën e

¹ S. Titini, *Huazimet dhe shqipërimet në terminologjinë e së drejtës*, Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe- Konferencë Shkencore, Tiranë, 2009. S. Morcka, *Fjala shqipe në fushën e së drejtës*, "Gjuha jonë", 1987, nr. 2. V. Meksi, *Për një terminologji të saktë juridike*, "Drejtësia popullore", 1959, nr. 6.

së drejtës, ka bërë që në dy dhjetëvjeçarët e fundit të përkthehet e të zhvillohet, për nevojat e mësimdhënies e të informimit në përgjithësi, një letërsi e gjerë juridike që, për fat të keq, është e ngarkuar me terma të huaj, duke cënuar ndjeshëm cilësinë dhe qartësinë në dhënien e njohurive. Në tekste e dokumente të ndryshme juridike vihet re, përveç përdorimit të panevojshëm të një numri të konsiderueshëm termash të huazuar nga anglishtja², mungesa e shënimeve për

² Puna “*Part-time*” mund të marrë forma të ndryshme. Ajo mund të krijohet nga një reduktim i orarit të punës ditore (*part-time* horizontal) ose nga një punë me kohë të plotë të kryer në ditë të alternuara gjatë javës, muajit, vitit (*part-time* vertikal), ose të punës *part-time mikst*, që kombinon dy precedentët e tipologjive *part-time* horizontal dhe *part-time* vertikal. Kjo situatë plotësohet me atë që legjislacioni francez, e quan “vajtje-ardhje”, që do të thotë se një punëmarrës me kontratë pune “*part-time*” ose me “*full-time*”, të rikthehet në tipin e mëparshëm të kontratës së punës, e anasjelltas. (K. Çela “*Aspekte të ridimensionimit të marrëdhënieve juridike të punës në këndvështrimin krahasues*”, Justinianu I, nr. 1, f. 86, Tiranë, 2009). Evropa është laborator i ideal për të studiuar si ndryshon ligji në veprim, sa shumë mund të zhvillohen kulturat e ndryshme ligjore, veçanërisht në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe nën influencën e të ashtuquajturit “*soft law*” në shtete të ndryshme. (G. Tafa “*Drejt një sociologjie evropiane*”, Justiniani I, nr. 1, f. 117, Tiranë, 2009). Bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shtëpi brokerimi etj.) që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve. (L. Gjonça, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe krimi i organizuar*”, f. 39, Justiniani I, nr. 1, Tiranë, 2009). Në praktikën e kohëve të fundit janë krijuar disa komisione të veçanta të quajtura *independent regulatory commissions*, si rezultat i praktikës që nuk ka të bëjë me kushtetutën dhe në bazë të një ligji të Kongresit. (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 90, Shblu, Tiranë, 2004.) Gjykata supreme i ka njohur presidentit të drejtën për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare pa qenë i nevojshëm miratimi i Senatit ose pa një *joint resolution* paraprak të Kongresit... (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 95, Shblu, Tiranë, 2004). Një rast tjetër ka të bëjë me të drejtën e *certification* të gjyqtarëve të apelit, me të cilën ata kërkojnë gjykimin paraprak të gjykatës mbi çështje të së drejtës... (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 98, Shblu, Tiranë, 2004). *Common lawyers* anglezë kanë përcaktuar disa rregulla të interpretimit *statutory* (*statutory interpretation o statutory construction*): *literal interpretation*- përjashtohet çdo teknikë interpretimi analogjik. (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 161, Shblu, Tiranë, 2004). *Welfare State*, përveç një prodhimtatrie të bollshme ligjore ka sjellë një mbiprodhim të akteve normative që janë në varësi të formave të ndryshme të kuadrit ligjor dytësor. (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 161, Shblu, Tiranë, 2004). Pas *statutory instrument act* të vitit 1946 mbretëresha ka të drejtë të nxjerrë me anë të autorizimit urdhra, rregulla, rregullore pasi ka dëgjuar edhe mendimin e Këshillit privat. (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 161, Shblu, Tiranë, 2004). Në Itali parashikohet diçka e ngjashme me “*guilty plea*” anglez. (A. Shegani, *E drejtë penale e krahasuar*, f. 116, Tiranë, 1999). Në raste serioze, i pandehuri do të përfaqësohet nga

shpjegimin e koncepteve e institucioneve të emërtuara prej termave të huaj në ato raste kur prania e tyre në gjuhë është kërkesë e domosdoshme për nevojat e komunikimit special³. Nuk mund të mos nënvizohet fakti se jo pak vështirësi lidhen edhe me shqiptimin e termave nga anglishtja të cilët, përgjithësisht, ruajnë formën grafike pa iu përshtatur gjuhës shqipe. Në këtë aspekt nuk mungon ndonjë rast kur, edhe pse bëhet fjalë për një term të huazuar, para viteve '90, që i është përshtatur sistemit fonetik e grafisë së shqipes, në ditët tona përdoret shpesh me formën që ka në anglisht pra, në gjuhën nga ka hyrë⁴.

Termet e huazuar nga anglishtja, në letërsinë juridike pas viteve '90, kanë hyrë në degë të ndryshme të së drejtës.

një avokat, ose (*barrister*), ose (*solicitor*). (A. Shegani, *E drejtë penale e krahasuar*, f. 70, Tiranë, 1999) ...mund të nxjerrin akte që ndikojnë drejtpërdrejt mbi sistemin e Shteteve anëtare (si në rastin e normave *self executing*). (S. Bana, E. Canaj, *E drejta e Bashkimit European*, f. 111, Tiranë, 2009). Veçantia e sistemit komunitar, në fakt, ka çuar doktrinën ta konsiderojë si një sistem *self-contained*... (S. Bana, E. Canaj, *E drejta e Bashkimit European*, f. 152, Tiranë, 2009).

³ Një nga format e administrimit elastik të fuqisë punëtore, pa dyshim, është kontrata e "job sharing". (K. Çela "Aspekte të ridimensionimit të marrëdhënieve juridike të punës në këndvështrimin krahasues", Justinianu I, nr. 1, f. 86, Tiranë, 2009). Rreziku rritet edhe më tepër sot kur software mund të jetë objekt i kontratës së "franchising", sipërmarrje, të një pune të varur pikërisht për arsye të mënyrës me të cilën lidhet me ndërmarrjen. (K. Çela "Aspekte të ridimensionimit të marrëdhënieve juridike të punës në këndvështrimin krahasues", Justinianu I, nr. 1, f. 90, Tiranë, 2009). Mund të riunifikojmë këtë model të përshkruar në rastin e kontratës së punës së përkohshme (të përkohshme, dhënie hua e punëtorëve deri te format më të fundit si *labour pool*). (K. Çela "Aspekte të ridimensionimit të marrëdhënieve juridike të punës në këndvështrimin krahasues", Justinianu I, nr.1, f. 92, Tiranë, 2009). Mjaft e rëndësishme është *e drejta e impeachment* kundër çdo funksionari publik të federatës, dhe akuza i takon Dhomës së përfaqësuesve, ndërsa gjykimi i takon Senatit. (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 91, Shblu, Tiranë, 2004).

...gjykata do të ishte e detyruar të nxirrte një *writ of mandamus* përkatës për të detyruar atë(presidentin) që ta përmbushë detyrën. (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 99, Shblu, Tiranë, 2004) ... në bazë të kërkesës së palës së interesuar nxjerr një *writ of certiorari*. (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 98, Shblu, Tiranë, 2004). Në të kundërt, kuadrit ligjor dytësor i përket e ashtuquajtura *contingency legislation*, që bazohet mbi një vendim të Kongresit me të cilin presidentit i dërgohet për vlerësim hyrja në fuqi e një statuti të caktuar, në lidhje me realizimin e një ngjarjeje të paqartë. (N. Shehu, *E drejta e krahasuar publike*, f. 162, Shblu, Tiranë, 2004).

⁴ Hyrja në EFTA e Mbretërisë së Bashkuar i lejonte asaj të mbante pozicionin e saj të privilegjuar në këmbimet tregtare në *Commonwelth*. (S. Bana, E. Canaj, *E drejta e Bashkimit European*, f. 15, Tiranë, 2009).

- Në fushën e së drejtës publike: *act of settlement, advisory opinions, Bill of Rights, case - law, Committal proceedings, Common Bench, common law, common lawyers, convention, civil law, civil lawyers, convention, Crown Court, Crown Prosecution Service, Diplock Courts, draft (kushtetues), distinguishing writ of mandamus, district attorney, enxhio (NGO), governance, grand jury, (seancë) hearing, impeachment, joint resolution, Kings Bench, kongresmen, konte, legal system, lider, lidership, lob, lobim, lobing, Magistrates Court, overruling, practice statement, Prosecution, prosecutor, raund (zgjedhesh), Reform Act, rules of contract, rules of law, rules of property, rules of procedure distinguishing, samit, (normë) self executing, standing committees, Senate Judiciary Committee, Star Chamber Courts, statute law, system self contained, Welfare State, writ of cestiorari, writ of mandamus etj.*

- Në fushën e së drejtës penale të krahasuar: *barrister, bill procedure, conspiracy, crime, Criminale Justice Act, criminal law, fornication, guilty plea, impeachment, indictable offence, judiciary acts, jury trial, justices of peace, killer, lapidation, misdemeanours, mobbing, offence, petty offences, nonindictable offences, plea in mitigation, pleads guilty, pleas of the crown, Prosecution of Offences Act, prospective overruling rules of procedure, serial killer, solicitor, summary offences, triable only indictment etj.*

- Në fushën e së drejtës civile e të detyrimeve: *copyright, faktoring, franchising, freehold, intellectual property, leasing, rules of contract, rules of property, sponsor etj.*

- Në fushën e së drejtës së punës - (kontratë e punës) *full time, (kontratë e punës) part-time, kontratë e job - sharing, labour pool, team leader etj.*

- Në fusha të tjera të së drejtës kanë hyrë terma si: *bord, joint stock company, joint venture - (e drejtë tregtare); landfill - (e drejtë mjedisi); Department of Peacekeeping operations (DPKO), International Commission on Intervention and State Sovereignty (KISS) - (e drejtë ndërkombëtare) etj.*

Arsyet e hyrjes së termave nga anglishtja në fushën e së drejtës janë të ndryshme:

Së pari, huazimet nga anglishtja lidhen me shtimin e degëve të reja të së drejtës, por edhe me zhvillimet më të reja në ekonominë kapitaliste dhe evolucionin e raporteve shoqërore që kanë ndikuar në shtimin e përpunimin e nocioneve e institucioneve të reja brenda degëve ekzistuese të së drejtës. Sipas kësaj logjike, huazimet, mendojnë disa studiues, janë rezultat i

pamjaftueshmërisë së mjeteve shprehëse që një gjuhë ka në inventarin e saj, të tjerë mendojnë se prirja për huazime lind nga nevoja për të emërtuar nocione e realie të reja, të panjohura më parë në gjuhën marrëse e për të dhënë nuanca më të holla e të përpikta kuptimore.

Së dyti, arsye të tjera jogjuhësore i kanë dhënë anglishtes një rol të privilegjuar duke rritur trysinë e saj në gjuhët e tjera. Në këtë drejtim mund të veçohen nga njëra anë globalizimi si proces i integritimit ekonomik e kulturor midis popujve në nivel botëror, që ka ndikuar në përhapjen e kulturës së qytetërimeve të fuqishme në jetën e vendeve më të vogla. Nga ana tjetër procesi i integritimit europian të Shqipërisë nxjerr në dukje peshën specifike që ka anglishtja si gjuhë kryesore në zhvillimin e veprimtarisë së institucioneve të Bashkimit Europian, dhe hartimin e legjislativës të detyrueshëm për t'u zbatuar nga vendet anëtare.

Së treti, studiuesit e motivojnë hyrjen në gjuhë të huazimeve nga anglishtja edhe me një varg arsyesish të tjera si: formimi gjuhësor i cinguar i individëve, njohja e pamjaftueshme e kulturës gjuhësore, dobësimi i edukimit gjuhësor, mosnjohja e leksikut të shqipes, shpesh përdorimi i fjalëve e termave të huaja përbën modë, shija ekzotike, tërheqja që provohet ndaj një gjuhe të huaj, vështirësia për të gjetur barasvlerësin në gjuhën marrëse apo mungesa e politikave shtetërore për mbrojtjen e gjuhës kombëtare⁵.

Në fondin e termave të së drejtës, të huazuar nga anglishtja dallohen:

a) terma që nuk kanë një barasvlerës në gjuhën shqipe e janë pranuar si të tillë për nevojat e komunikimit special të kësaj fushe. Në këtë grup bëjnë pjesë:

- *terma ndërkombëtare*, pra, terma që shqipja i ka të përbashkët me gjuhët e tjera dhe i ka përvetësuar duke i bërë pjesë të saj si: *peticion, mocion, rezolutë, samit, korporatë, aparteid, komonuelth, dividend, negociata, kongresmen, bojkot, lob* që kanë hyrë para viteve '90 e të tjera si: *franchising, faktoring, bos, koalicion, precedent, tender, trafik (droge)* etj që kanë hyrë pas viteve '90.

- *terma nga anglishtja* që emërtojnë nocione e institucione karakteristike për botën anglosaksone e për rrjedhojë prania e tyre në gjuhë përlligjet, sa herë flitet për sistemin e së drejtës së këtyre vendeve si: *bill procedure, Bill of Rights, felonies, Departamenti i Lordit Kancelar, solicitor,*

⁵ H. Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, SF, 2002/3-4. H. Pasho, *Fjalët e huaja në gjuhën letrare shqipe*, SF, 1999/1-2. A. Duro, *Për zëvendësimin e fjalës së huaj*, "Gjuha jonë", 1989, 3. E. Stavileci, *Terminologjia e administratës*, Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe-Konferencë shkencore, Tiranë, 2009.

common lawyers, civil lawyers, contingency legislation, impeachment, writ of certiorari, writ of mandamus etj.

b) terma që megjithëse e kanë barasvlerësin shqip, nga mosnjohja e të dy gjuhëve në të njëjtin nivel apo nga pakujdesia, përdoren pa qenë nevoja në anglisht: *raund* (zgjedhësh) - *fazë* (zgjedhësh), (kontratë) *full time* - (kontratë) *me kohë të plotë*, (kontratë) *part time* - (kontratë) *me kohë të pjesshme*, *grand jury* - *juria e madhe*, *legal effects* - *pasojat ligjore*, *privacy-privatësi*, *governance* - *qeverisje*, *demurrer* - *mbrojtja*, *obstruksion* - *pengesë*, *copyright* - *e drejta e autorit*, *investigim* - *hetim*, *overruling* - *anullim*, *killer* - *vrasës*, *serial killer* - *vrasës serial*, *standing committees* - *komisione të përhershme / qëndrueshme*, (seancë) *hearing* - (seancë) *dëgjimore*, *intellectual property* - *pronësi intelektuale*, *summary offences* - *vepra penale me rrezikshmëri të vogël*, *enxhio (NGO)* - *organizatë joqeveritare*, *joint stock company* - *shoqëri anonime*, *criminal law* - *e drejta penale*, *freehold* - *e drejta e pronësisë*, *conspiracy* - *komplot*, (vepër penale) *triable only indictment* - (vepër penale) *e gjyqeshme vetëm me kallëzim*, *Welfare State* - *shtet social / shtet i mirëqenies*, *Star Chamber Courts* - *Gjykata e Kancelarëve të Lartë*, *Crown Prosecution Service* - *Shërbimi i ndjekjes penale pranë Kurorës / Prokurori*, *Prosecution of Offences Act* - *Akti për ndjekjen e veprave penale*, *Magistrates Court* - *Gjykata e Magjistratëve*, *advisory opinions* - *mendim këshillues*, *Crown Court* - *Gjykata mbretërore*, *Diplock Courts* - *Gjykata pa juri*, *Senate Judiciary Committee* - *Komiteti gjyqësor i Senatit*, *Magistrates Courts Act* - *Akt i Gjykatës së Magjistratëve*, *Criminale Justice Act* - *Akt i Drejtësisë penale*, *Common Bench* - *Gjykata e zakonshme*, *Kings Bench* - *Gjykata e mbretit*, *The Assizes* - *Gjykata e Krimeve të Rënda* etj. Një grup më vete përbëjnë termat e huazuar nga anglishtja, barasvlerësit e të cilëve janë terma po të huaj që kanë zënë vend në përdorim dhe janë bërë pjesë e leksikut të shqipes: *draft* (kushtetues) - *projekt (kushtetutë)*, *staf* (i qeverisë) - *personel* (i qeverisë), *prosecutor* - *prokuror*, *barrister* - *avokat*, *inkriminim* - *akuzë*, *rules of contract* - *dispozita të kontratës*, *rules of procedure* - *dispozita procedurale* etj.

Huazimet e grupit të parë, ku përfshihen terma ndërkombëtarë dhe terma të cilët gjuha ende nuk mund t'i japë me mjetet e veta leksikore, janë të domosdoshme. Numri i tyre është shtuar kohë pas kohe për të emërtuar nocione e realie të reja, që shfaqen në procesin e zhvillimit në fushën e së drejtës, por dhe janë përvetësuar nga shqipja, duke hyrë në fondin e saj. Këto huazime janë një burim i drejtëpërdrejtë i pasurimit të terminologjisë së një fushe, por njëherësh, edhe i tërthortë, sepse bëhen tema prodhuese për formimin e termave të reja. Ndërsa huazimet e grupit të dytë, të quajtura edhe huazime "luksi", dëmtojnë gjuhën, sepse thyejnë qartësinë e kuptueshmërinë e komunikimit special. Është kjo kategori huazimesh që shqetëson gjuhëtarët, si specialistë të fushës, por edhe ndjeshmërinë gjuhësore të çdo folësi të thjeshtë

që ka një nivel të mirë të njohjes së gjuhës amtare. Ndaj tyre duhet mbajtur një qëndrim i prerë duke i mënjeluar plotësisht meqenëse nuk i sjellin asnjë vlerë të re gjuhës, përkundrazi e varfërojnë duke lënë në hije fjalën shqipe.

Një pjesë e huazimeve nga anglishtja janë bërë tema prodhuese për fjalë të reja që i dëgjojmë e i ndeshim gjithnjë e më shpesh në përdorim, si: *trafik - trafikoj - trafikim - i trafikuar - trafikant; draft - draftoj - draftim - i draftuar; broker - brokerim; inkriminim - inkriminim - i inkriminuar; obstrukcion - obstrukcionizëm - obstrukcionista* etj. Terma të huazuara nga anglishtja më herët janë bërë, gjithashtu, tema prodhuese për terma që emërtojnë nocione, dukuri, forma të organizimit që përdoren dendur në ditët e sotme: *lob - lobo - lobim - lobing - lobist; bojkot - bojkotoj - bojkotim - i bojkotuar - bojkotues; negocij - negocij - i negociuar - negociues - negociata - negociator* etj.

Huazimet nga anglishtja pas viteve '90 kanë hyrë, kryesisht, si huazime që nuk i janë përshtatur sistemit fonetik dhe grafisë së gjuhës shqipe duke ruajtur, në përdorim, veshjen tingullore dhe grafinë e gjuhës nga vijnë. Huazime të tilla bëhen më "të huaja" edhe në ato raste kur, megjithëse janë të domosdoshme në gjuhë për të emërtuar nocione të reja të fushës, vështirësohet përdorimi i tyre nga ata që njohin gjuhë të tjera të huaja, por jo anglishten.

A. Xhuvani shkruan: "asnjë gjuhë nuk mund t'i rreshtet ndikimit nga gjuhët e tjera", më tej shton "... n'pastrimin e gjuhës duhet një masë, një rrugë e mesme se asnjë gjuhë nuk mund të jetë e pastër dhe e dlië nga çdo gjë e huaj"⁶. Prandaj huazimi duhet bërë sipas rregullave të cilat e kufizojnë në atë masë që është i vlefshëm për gjuhën.

Janë përcaktuar kriteret shkencore për qëndrimin që duhet mbajtur ndaj huazimeve duke mbajtur parasysh, që të pastrohet terminologjia nga ngarkesa e tepërt me fjalë të huaja, duke u mbështetur në mundësitë reale që ka gjuha jonë për të shqipëruar termat shkencorë jondërkombëtarë, duke i dalluar nga ata ndërkombëtarë që gjenden në disa gjuhë.

Për shqipërimin e termave të huaj duhen shfrytëzuar gjerësisht tipat fjalëformues më prodhimtarë të shqipes, terminologjizimi i fjalëve të leksikut të gjuhës së përgjithshme që me zgjerimin e kuptimit aftësohen për të shënuar koncepte të reja, rivlerësimi i termave të vjetër dhe shqipërimi i termave jondërkombëtarë, duke sqaruar se termat ndërkombëtarë nuk i kanë të përbashkët vetëm dy ose më shumë gjuhë neolatine, por edhe gjuhë të tjera.

Huazimi nuk mund të shmanget sepse popujt japin e marrin në mënyrë të vazhdueshme me njëri-tjetrin, në këtë pikë gjuhët nuk mund të mbeten jashtë këtij ndikimi të ndërsjellë. Nëse fjalët e huaja janë të domosdoshme kur

⁶ A. Xhuvani, *Pastërtia e gjuhës, Pastërtia e gjuhës në shtyp dhe letërsi*, Vepra 1, Tiranë, 1980.

gjuha nuk mund t'i emërtojë me mjetet e saj leksikore sende e nocione të reja, nuk mund të thuhet e njëjta gjë kur ato depërtojnë në gjuhë duke gjalluar krahas fjalës shqipe apo duke e mënjanuar atë. Ky problem bëhet edhe më i mprehtë kur flitet për leksikun terminologjik, ku shfaqja e dukurive të tilla si sinonimia e shumëkuptimësia ndikojnë negativisht në qartësinë e saktësinë që duhet të karakterizojë komunikimin special. Veç kësaj, prania e pavend e termave të huaj çënon punën e madhe të bërë për formësimin e një terminologjie kombëtare në fusha të ndryshme, përfshirë edhe atë të së drejtës.

Huazimet ndikojnë në shtresëzimin e leksikut për nga përdorimi që do të thotë tkurrje e lëndës së gjuhës kombëtare dhe zgjerimi i lëndës së huaj. Pasojat janë të dëmshme, po të mendohet se nuk bëhet fjalë për një humbje thjesht numerike, por më gjerë e pasurisë shprehëse që karakterizon shpirtin e çdo populli dhe përcakton individualitetin e një kombi. Ndaj del si detyrë të punohet për përdorimin e kujdesshëm të gjuhës dhe pasurimin e mëtejshëm të saj për të mënjanuar, në këtë mënyrë, të ashtuquajturin kolonizim linguistik e, për rrjedhojë atë intelektual. Në këtë drejtim është e nevojshme mbështetja e institucioneve ekzistuese, pse jo krijimi i institucioneve të reja të specializuara që do të filtrojnë me kujdes termat e huaj të panevojshëm për të ruajtur të pastër gjuhën shqipe nëpërmjet zëvendësimit të tyre me barasvlerësit shqip dhe krijimin e termave të rinj me mjetet leksikore të vetë gjuhës kur kjo është e mundur. Po kështu një ndihmë e madhe do të ishte hartimi i politikave shtetërore dhe miratimi i një ligji të veçantë për mbrojtjen e gjuhës kombëtare e, mbi të gjitha, zbatimi në praktikë duke i kushtuar kësaj çështjeje vëmendjen e duhur.

BIBLIOGRAFI

- A. Duro, *Për zëvendësimin e fjalës së huaj*, "Gjuha jonë", 1989, nr. 3.
- A. Xhuvani, *Pastërtia e gjuhës, Pastërtia e gjuhës në shtyp dhe letërsi*, Vepra 1, Tiranë, 1980.
- E. Stavileci, *Terminologjia e administratës*, Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe-Konferencë shkencore, Tiranë, 2009.
- H. Çipuri, *Shqipërimi, njësimi dhe pasurimi i mëtejshëm i terminologjisë ushtarake*, Gjuha jonë 1984, nr. 2.
- H. Pasho, *Fjalët e huaja në gjuhën letrare shqipe*, SF, 1999/1-2.
- H. Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, SF, 2002/3-4.
- I. Goçi, *Një vështrim rreth përdorimit dhe zëvendësimit të disa termave të huaj*, "Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi" Prishtinë, 1988.

- K. Gostentschnigg, *Probleme përkthimore dhe terminologjike në përkthimin e teksteve të filozofisë lindore*, “Hylli i dritës”, 2006, nr. 2.
- S. Morcka, *Fjala shqipe në fushën e së drejtës*, “Gjuha jonë”, 1987, nr. 2.
- S. Titini, *Huazimet dhe shqipërimet në terminologjinë e së drejtës*, Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe- Konferencë Shkencore, Tiranë, 2009.
- V. Meksi, *Për një terminologji të saktë juridike*, “Drejtësia popullore” 1959, nr. 6.
- V. Sejko, *Për një terminologji juridike të njëshme dhe të pastër*, “Drejtësia popullore”, 1966, nr. 4.

SUMMARY

BORROWINGS FROM ENGLISH TO ALBANIAN LANGUAGE LEGAL TERMINOLOGY

The addition of terms that have entered from English in the field of law, after the '90s, is related to the addition of new branches of law and other non-linguistic factors that have given English a privileged role by increasing its influence on other languages.

The fund of borrowed terms from English includes:

1. international terms: *petition, motion, resolution, summit, corporation, apartheid, commonwealth, dividend, negotiation, congressman, boycott, lobe that entered before the '90s and others such as: franchising, factoring, trafficking (drugs), coalition, precedent, tender* etc. that entered after the '90s.

2. terms from English that name notions and institutions peculiar to Anglo-Saxon world and therefore their presence in language is justified any time we refer to the legal systems of these countries such as *boss, cartel, county, Bill of Rights, felonies, Lord Chancellor's Department, Judicature Acts, common lawyers, civil lawyers, joint resolution* etc.

3. terms borrowed from English that have their Albanian equivalents: *raund* (zgjedhesh) - *fazë* (zgjedhesh), (kontratë) *full time* - (kontratë) *me kohë të plotë*, (kontratë) *part time* - (kontratë) *me kohë të pjesshme*, *privacy* - *privatësi*, *governance* - *qeverisje*, *demurrer* - *mbrojtja*, *copyright* - *e drejta e autorit*, *investigim* - *hetim*, *overruling* - *anullim*, *killer* - *vrasës*, *serial kille* - *vrasës serial*, *standing committees* - *komisione të përhershme / qëndrueshme*, (seancë) *hearing* - (seancë) *dëgjimore*, *intellectual property* - *pronësi intelektuale*, *enxhio (NGO)* - *organizatë joqeveritare*, *statue law* - *e drejta statutore*, *joint stock company* - *shoqëri anonime*, *freehold* - *e drejta e*

pronësisë. A group of its own is formed of borrowed terms from English which equivalents are foreign terms themselves that have come into use and have become part of Albanian language lexicon: *draft* (kushtetues) - *projekt* (*kushtetutë*), *staf* (i qeverisë) - *personel* (i qeverisë), *barrister* - *avokat*, *impeachment* - *akuzë*, *inkriminim* - *akuzë* etc.

A part of borrowings from English have become productive bases for new words that we hear and encounter more frequently in use such as *trafik* - *trafikoj* - *trafikim* - *i trafikuar* - *trafikant*; *draft* - *draftoj* - *draftim* - *i draftuar*; *inkriminim* - *inkriminim* - *i inkriminuar*; *obstruksion* - *obstruksionizëm* - *obstruksionist* (traffic - trafficking - the - trafficked trafficker; draft - drafting - drafted; incriminate - incrimination - indicted; - etc:). Early borrowed terms from English have also been made productive bases for terms that designate concepts, phenomena, forms of organization used widely nowadays:

lob - *loboj* - *lobim* - *lobin* - *lobist*; *bojkott* - *bojkotoj* - *bojkotim* - *i bojkotuar* - *bojkotues*; *negocioj* - *negocim* - *i negociuar* - *negociues* - *negociata* - *negociator* etc.

A part of the terms borrowed from English are essential for the enrichment of the relevant domain terminology. Whereas the rest of the borrowed terms, otherwise called "luxury" borrowings, damage the language since they affect the clarity and understanding of special communication. These unnecessary foreign terms should be avoided and replaced with the Albanian equivalents and new terms formed of Albanian lexical means when this is possible. Also a great contribution to the maintenance of Albanian language pure would be made by designing state policies and adopting a group of laws that aim to protect the national language.